

*16 ditë aktivizëm  
kundër dhunës ndaj grave  
dhe dhunës në familje*

**25.11 - 10.12**

## PËRKUFIZIMET PËR DHUNËN NË FAMILJE

(Përkufizimi i dhunës në familje sipas  
Kodit Penal të RM, Nen.122 .faq.17)

„Me përkufizimin dhunë në familje nënkuftojmë shpërdorim, fyerje e vrazhdë, që e kërcnon sigurinë, abuzim fizik, seksual ose forma tjera të dhunës fizike ose psikologjike që shkaktojnë një ndjenjë të kërcënimit, pasigurisë apo frikës nga prindërit, bashkëshorti / ja ose fëmijët, ose persona të tjerë që jetojnë në një lidhje martesore ose jashta martesore apo në rreth të përbashkët familjar, si dhe në drejtim të një ish bashkëshorti ose persona që janë në marrëdhënie të ngushta personale.“

## LLOJET E DHUNËS NË FAMILJE:

### Dhuna psikologjike definohe si:

Kontrollim, izolim, xhelozit dhe vuajtje emocionale e gruas, një gjëndje që i fyeni gratë, dominim i burrave në familje, fjala e tij duhet të jetë e fundit, frikësim, kërcënim se do ta lëndon ate apo të afërmit e saj. Ndalesë të punojë jashtë shtëpisë, poshtërim, nën-vlersim përparrë të tjerëve, detyrim për të marrë leje për kujdes shëndetësor, ndalesë për plotesimin e ndonjë nevoje jetësore elementare, ndalesë për vendimarrje, kërkesë këmbëngulëse të dinë në çdo moment se ku gjendet, me kë shoqerohet etj.

### Dhuna fizike definohet si:

Përdorimi i forcës fizike, apo kërcënim se do të ushtrohet dhunë fizike ndaj gruas nga bashkëshorti i saj (i tanishëm ose i mëparshëm), nga partneri / ja jashtamartesore i tanishëm apo i mëparshem ose ndonjë anëtar tjetër i rritur i familjes.

### Dhuna seksuale përkufizohet përmes disa sjelljeve të veçanta:

Përdhunim, marrëdhënie seksuale të padëshiruara, seks poshtëruar, të detyruarit të shiqohen filma pornografike etj.

*„16 Ditët e Aktivizmit  
kundër dhunës ndaj grave dhe  
të dhunës në familje“  
është një fushatë ndërkombëtare  
e cila fillon 25 nëntor dhe  
përfundon më 10 dhjetor me Ditën  
Ndërkombëtare të Drejtave të  
Njeriut, e cila simbolikisht vuri në  
dukje se dhuna ndaj grave është  
shkelje e rëndë e drejtave të njeriut.*



Iniciativa Qytetare e grave „ANTIKO”

[www.antiko.org.mk](http://www.antiko.org.mk)

e-mail: [contact@antiko.org.mk](mailto:contact@antiko.org.mk); [antico@t-home.mk](mailto:antico@t-home.mk)



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Центр за  
ИНСИТУЦИОНАЛЕН  
РАЗВОЈ - ЦИРа  
CIRa • ЦИРа

*Ky publikim, u mundësua në suaza të programit CIVICA  
Mobilitas - implementuar nga CIRa dhe finansiarisht e  
mbështetur nga SDC. Mendimet e shprehura këtu janë mendime  
të autorit/autorëve dhe nuk i reflektojnë qëndrimet e CIRa-së  
dhe SDC-së.“*

**MOS HESHT,  
PARAQITE DHUNËN  
DHE DHUNUESIN !**

**Lufto kundër  
dhunës ndaj  
grave dhe fëmijëve**

## FTESË DREJTUAR TË RINJEVE:

**Gjithë djemëve dhe vajzave të reja të bashkohen në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe asaj në familje**

Ne ju ftojmë të gjithë juve që jeni pjesë më vitale e shoqërisë sonë. Ju në të cilët/lat besojmë se keni vetëdijë, fuqi dhe vullnet të mirë të bëni ndryshime pozitive. Ju që jeni të guximshëm, humanë dhe bashkëkohor. Të gjithë ju, që nuk e toleroni padrejtësinë, dhe nuk lejoni askush të diskriminoj, maltretojë dhe torturojë, të cënojë të drejtën elementare për dinjitet dhe integritet njerëzorë.

Ngreni zérin tuaj!

Thuani JO dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje! Mbroni mijëra nëna, motra, vajza, gra dhe bashkëshorte. Luftoni kundër rrënjeve të dhunës të cilat qëndrojnë në vlerat patriarkale, paragjikimet dhe streotipet egzistuese që prodhojnë pabarazi në mes të gjinive.

Barazia gjinore është vlera e vetme që eliminon diskriminimin në shtëpi dhe pastaj edhe në shoqëri. Ajo siguron prosperitet, paqë dhe marrëdhëniet të shëndosha në suaza të familjes, në komunitet. E siguron përparimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë - paqës dhe sigurisë botërore.

Dhuna nuk është problem vetëm i grave, ajo është një problem social. Mos lejoni mijëra, nëna, motra, bashkëshorte, vajza të reja të ngelin vetëm në fatin dhe luftën e tyre për një jetë më dinjitoze - pa dhunë. Ejani së bashku të kontribuojmë që miliona fëmijë mos të rriten në familje ku dhuna është e pranishme. Ata meritojnë të jetojnë në paqe dhe mos të janë viktimi e dhunës, mos të mësojnë të janë brutal dhe dhunues të ardhshëm.

Prandaj, Informohuni, mendoni, vendosini, bashkohuni dhe vepron... ju jeni pikërisht nga ata/ato që mund të japid përmbytje dhe vlera të reja jetës dhe marrdhënjeve ne mes të gjinive. Zgjatni dorën e ndihmës - kontribuoni në eliminimin e dhunës në familje.

**DHUNËN, ASGJË NUK MUND TA ARËSYETOJË !**

**PRANDAJ, NGREJE ZËRIN - LUFTO NDAJ**

**PARGJUKIMEVE (MITEVE) TË KRIJUARA PËR DHUNËN, SEPSE FAKTET VËRTETOJNË !**

**FAKTET TREGOJNË:**

**Miti:** Viktima është shkakëtare për paraqitjen dhunës!

**Argumenti:** Dhuna është i shkaktuar nga abuzesi. Ai është përgjegjës për veprimet e veta!

**Miti:** Dhuna në familje dhe ajo në mes të partnerëve është çështje e tyre private!

**Argumenti:** Dhuna në familje është një problem serioz social - shoqëror!

**Mite:** Nëse viktima largohet nga keqtrajtuesi, dhuna do të ndalet!

**Argumenti:** Shumica e viktimate janë në rrezik më të madh, pasi ata largohen nga keqtrajtuesi!

**Miti:** Incidencia e dhunës në familje është e mbi-theksuar, ajo nuk është aq problem i madh!

**Argumenti:** Treguesit statistikor dhe pasojat e dhunës në familje alarmojnë se ajo është një problem shumë vështirë social - shoqëror.

**Miti:** Gratë janë njëllëj të dhunshme si edhe burrat!

**Argumenti:** Burrat janë autorë më të shpeshtë të dhunës në familje (95% e viktimate janë gra).

**Miti:** Një sulm fizik i burrit ndaj partnerit të vet është një ngjarje e izoluar dhe mundësia e përsëritjes është e vogël!

**Argumenti:** Dhuna fizike është pjesë e një formë komplekse të pushtetit dhe kontrollit ndaj partnerit.

**Miti:** Një njeri që vetëm është kërcënuar me sulme fizike, nuk është keqtrajtues.

**Argumenti:** Kërcënimet janë forma të veçanta të abuzimit!

**Miti:** Fëmijët kanë nevojë për një baba, edhe pse është i dhunshëm ndaj nënës së tyre. Gruaja për hir të fëmijëve të tyre duhet të durojnë dhe të mbeten me partneritet me të.

**Argumenti:** Fëmijët që rriten në familje të këtilla, mësojnë të janë ne jetën e tyre dhunues të adhshëm.

**Miti:** Dashuria nuk e përjashton dhunën!

**Argumenti :** Dhuna dhe dashuria nuk shkojnë së bashku!

**LUFTO KUNDËR DHUNËS! PËR VETE, FËMIJËT, TË AFËRMIT, MIQTË DHE FQINJËT!**

NË EMËR TË PROGRESIT DHE TË PAQES SË QËNDRUESHME NË NIVEL LOKALË DHE BOTËRORË!

**DHUNA GJINORE DHE  
DHUNA NË FAMILJE !**

Dhuna kundër grave është një vepër penal, një formë e shkeljes së të drejtës elementare të njeriut për jetë, dinjitetet dhe integritet trupor.

Dhuna kundër grave është një reflektim shekullorë i statusit të pabarabartë midis femrave dhe meshkujve, gjegjësisht shprehje e ndarjes së pabarabartë të fuqisë. Ajo është e pranishme në të gjitha fazat e zhvillimit të shoqërisë. Rrënjet e dhunës gjinore shtrihen thellë në strukturat e shoqërive. Vlerat egzistuese patriarkale prodhojnë paragjikime dhe stereotipe të cilat e „ushqejnë“ mundësojnë/arsyetojnë dhunën ndaj grave. Kjo kontribuon që femrat të janë në pozitë më të diskriminuar në kahasim me meshkujt.

Si pasojë e roleve dhe marrëdhëniet të caktuara gjinore në shoqëri, paraqitet dhuna kundër grave në të gjitha format e saja - fizike, psikologjike, seksuale, ekonomike etj.

**STATISTIKAT SUGJEROJNË DHE ALARMOJNË !**

Sipas statistikave ndërkombëtare dhe vendore viktimat më të mëdha të dhunës janë gra dhe fëmijë. Në R. Maqedonisë janë të pranishm të gjitha 3 llojet kryesore të dhunës kundër grave dhe në familje. Çdo e 2-ta grua është viktimë e dhunës psikologjike, çdo e 6-ta grua ka pësuar abuzim fizik, ndërsa çdo 10 ka përfjetuar dhunë seksuale. (Studim, Jeta në Hije-ESE)

Dhuna është shpërdorim të fuqise. Shpesh dhuna për keqtrajtuesin-dhunuesin paraqet një instrument përritjet e sjelljes së dëshiruar tek viktima. Mënyrë përritjet e kontrolluar sjelljen dhe jetën e saj me anë të forcës, frikësimit dhe manipulimit.

Dhuna ndaj grave dhe fëmijëve më së shumti është e pranishëm në suazat e familjes, aty ku sipas logjikës se shëndoshë duhet të jetë vend më i sigurtë përritjet e anëtarëve saj. Por përritjet e saj më raste kjo nuk është kështu.